



Prishtinë, 02.10.2018

**Përgjigjet në komentet e pranuar gjatë procesit të konsultimit publik
për
Shqyrtimin e tarifave të energjisë termike – Raporti për të Hyrat e Lejuara për NQ
Termokos – sezoni 2018/2019**

1. Hyrje

Në përputhje me kërkesat ligjore, me datë 12 shtator 2018, ZRRE ka nxjerrë në konsultim publik Draft Raportin: Vlerësimet Preliminare për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për NQ Termokos për sezonin 2018/2019. Me këtë rast të gjithë palët e involvuara dhe publiku i gjerë janë ftuar për të dhënë komentet e tyre në këtë Raport. Po ashtu në kuadër të procesit të konsultimit publik, ZRRE ka patur takim me NQ Termokos ku janë diskutuar dhe dhënë shpjegime për disa nga komponentët kryesorë të të Hyrave të lejuara. Gjatë konsultimit publik ZRRE ka pranuar komentet me shkrim nga NQ Termokos dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP); në vijim janë dhënë përgjigjet në këto komente.

2. Përgjigjet në komentet e pranuar nga NQ Termokos

Koment 1: Kostoja e ujit për rimbushjen e sistemit të ngrohjes qendrore

“Propozimi nga Termokos për koston e ujit në vlerë prej 130,000 €, është bazuar në vlerën reale sipas faturave për shpenzimet e ujit, e paraqitur në Raportimin Rregullativ për realizimet e sezonit 2017/2018 (tek shpalosja e Pasqyrës B) e cila është 129,956.86 euro.

Në kuadër të kësaj shume janë përfshirë të gjitha shpenzimet për ujin , që në Termokos përfshinë katër kategori:

1. Rimbushjen e sistemit të Kogjenerimit Termokos –“Kosova B” - 20,086.17 euro
2. Rimbushja e sistemit primar të shpërndarjes -78,385.04 euro
3. Termonënstacionet e distribuimit - 31,280.63 euro,
4. Shpenzimet e ujit në objektin administrativ të Termokosit - 205.03 euro

Total : 129,956.86 euro

Prandaj, duke u bazuar në faktin se në vlerën e propozuar nuk është e përfshirë vetëm sasia e parashikuar të ujit 66,500 m³ për rimbushje të sistemit, ju lutemi që ta aprovoni vlerën e propozuar nga Termokosi prej 130,000.00 euro në mënyrë që të mbulohet kostoja reale për shpenzimin e ujit.”

Përgjigje



Në vlerësimin për këtë kosto, ZRRE është bazuar në sasinë e planifikuar të shpenzimit të ujit 66,500 m³ dhe në tarifatat aktuale të shërbimeve të ujit për KRU Prishtina. Në vijim citati i shkëputur nga Raporti i ZRRE-së për të Hyrat e Lejuara:

“Vlerësimi nga ZRRE - NQ Termokos ka propozuar koston në vlerë prej 130,000 €, për sasinë e parashikuar të ujit 66,500 m³ për rimbushje të sistemit; kjo kosto paraqet një rritje të vogël në krahasim me realizimin në sezonin e kaluar 2017/2018. ZRRE ka kryer vlerësimet duke u bazuar në konsumin e parashikuar dhe tarifatat aktuale të shërbimeve të ujit për KRU Prishtina – për shërbimin e ujësjellësit: 0.85 €/ m³ dhe për shërbimin e ujërave të zeza: 0.11 €/m³. Rrjedhimisht, bazuar në llogaritjet përkatëse, si dhe duke konsiderua një shtesë të sasisë së shpenzuar të ujit për mbushje të sistemit nga ajo e parashikuar, lejon koston e ujit prej **85,000 €**, që vlerësohet si reale dhe e mjaftueshme”.

Përveç komentit me shkrim, në takimin me përfaqësuesit e NQ Termokos, na janë ofruar shpjegime shtesë se gjatë parashikimit të shpenzimit të ujit kanë bërë një lëshim duke dhënë vetëm sasinë e parashikuar për rimbushjen e rrjetit primar të sistemit të shpërndarjes, ndërsa nuk janë dhënë vlerat tjera të shpenzimit të ujit. Gjithashtu duhet theksuar se gjatë monitorimit të realizimeve të sezonit të kaluar, ZRRE ka konstatuar realizimit e kësaj kostoje në vlerën e lartcekur 129,957 €. Pra parashikimi i NQ Termokos ka qenë i bazuar tërësisht në realizimin e kësaj kostoje në sezonin e kaluar sipas faturave nga KRU Prishtina, ku është bërë një rrumbullakim në vlerën 130,000 €.

Duke marrë parasysh shpjegimet dhe detalizimet më lartë ZRRE ka rillogaritur koston e ujit si në vijim:

- Kostoja e ujit për rimbushjen e sistemit primar të shpërndarjes (bazuar në sasinë e parashikuar të ujit prej 66,500 m³ dhe tarifatat respektive për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza): **64,000 €;**
- Kostoja e ujit për rimbushjen e rrjetit të Kogjenerimit Termokos –“Kosova B”: **20,086 €;**
- Kostoja e ujit për nënstacione: **31,281 €**
- Kostoja e ujit për objektin administrativ: **205 €**
- **Total kostoja e ujit: 115,572 €**

Koment 2: Kostot e shitjes dhe tjera administrative

“Sa i përket pjesës rreth “shpenzimet e provizioneve të llogarive të arkëtueshme” (apo lejimet për borxhet e këqija dhe të dyshimta), ndërmarrja Termokos bën provizionimin e llogarive të arkëtueshme më të vjetra se 6 muaj çdo fund vit, por poashtu bën edhe njohjen e të hyrave nga inkasimet e këtyre shpenzimeve nga vitet paraprake. Kurse, sa i përket “Shpenzimeve të tatimit në fitim”, kjo llogaritet sipas procedurave të Ligjit për Tatimin në të Ardhura të Korporatave. Shikuar nga raporti i vitit 2017, ku ndërmarrja kishte mbi 2 milion euro fitim (paraqitur në Raportin e Auditimit 2017) dhe duke u bazuar në Ligjin për Tatimin në të Ardhura të Korporatave për vitin vijues, tatimi në fitim duhet të kalkulohet me 110 % e vitit paraprak. Deri në vitin e kaluar, si pasojë e faljes së borxheve (bazuar në kërkesën e konsumatorëve të mundësuar nga Ligji për Faljen e Borxheve Publike), ndërmarrja ka qenë në humbje. Por nga ky vit, mosaplikimi i faljeve të borxheve ka ndikuar që menaxhmenti t’a parashikojë se do të paguaj edhe tatimin në fitim.”



Prandaj bazuar në faktet e lartcekura, ju lutemi që ta aprovoni vlerën e propozuar nga Termokosi.”

Përgjigje:

Fillimisht duhet theksuar se në kostot e shitjes dhe tjera administrative e cila është propozuar nga NQ Termokos në vlerë 1,050,000 €, janë të përfshira 2 nën-komponentë: nën-komponenti “shpenzimet e provizioneve të llogarive të arkëtueshme¹” në vlerë prej 661,389 €, dhe nën-komponenti “Shpenzimet e tatimit në fitim” e cila është paraqitur një vlerë mjaft e madhe prej 220,000 € dhe e rritur disa herë krahasuar me realizimet e sezonit të kaluar.

Në vlerësimin e kësaj kostoje të paraqitur në Raport është sqaruar se nën-kuptohet se këto dy nën-komponentë janë të ndërlidhur me procesin e shlyerjes së borxheve gjer në vitin 2008 në përputhje me Ligjin për faljen e Borxheve Publike. ZRRE e vlerëson këtë si një operacion kontabël i domosdoshëm për të reflektuar shlyerjen e borxheve sipas ligjit në fjalë; dhe rrjedhimisht këto kosto nuk i konsideron si subjekt të shqyrtimit tarifor. Në fakt këto dy nën-komponentë trajtohen dhe janë të përfshira në pozicione tjera të të Hyrave të lejuara si Borxhi i Keq dhe në Normën e Kthimit, në Asete. Më konkretisht në vijim:

- Në pajtim me dispozitat e Rregullës për Vendosjen e Çmimeve të Energjisë Termike, kostoja e borxhit të keq llogaritet si përqindje e arsyeshme në të hyrat e ndërmarrjes (d.m.th. vlerën e faturimit nga shitja e ngrohjes). Kjo ‘përqindje e arsyeshme’ duhet të caktohet në atë mënyrë që të nxis ndërmarrjen për të shtuar përpjekjet për rritjen e nivelit të arkëtimit të pagesave nga konsumatorët, por njëkohësisht merr parasysh se një shumë e konsiderueshme objektivisht nuk mund të arkëtohet, pra do të mbetet si borxh që faktikisht nuk do të realizohet. Nga sa u tha më lartë ZRRE mendon se niveli i borxhit të keq prej 5% është i arsyeshëm, dhe rrjedhimisht kostoja e borxhit të keq llogaritet në vlerën prej **301,840 €**. Gjithashtu edhe praktikata e rregullimit të çmimeve si në vend ashtu edhe ndërkombëtare e përcaktojnë përqindjen e arsyeshme të borxheve të këqija në një nivel prej 5%.
- Gjithashtu, siç është përcaktuar në kapitullin 3.4.1 të Raportit, gjatë llogaritjes së WACC-ut gjegjësisht Normës së Kthimit në formulat përkatëse është marrë në konsideratë tatimi në fitim i korporatave prej 10%. Konkretisht është përfshirë në formulën për llogaritjen e kostos së Ekuitetit (k_E) – në fq. 21 të Raportit.

Nga argumentimet më lartë ZRRE mbetet pranë vlerësimeve të veta për mos-përfshirje të dy nën-komponentëve të lartpërmendur në Kostot e Shitjes dhe Tjera Administrative, dhe rrjedhimisht këto kosto lejohen në vlerën **168,611 €**, siç është përcaktuar në Raport.

3. Përgjigjet në komentet e pranuar nga INDEP

INDEP, si koment të vetin ka dërguar dokumentin: **“Faturimi i Qytetarëve dhe Parimet për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për Ngrahoren e Qytetit Termokos SH.A. Sezoni i Ngrahjes 2018/2019”**. Fillimisht duhet përmendur se në këtë dokument nuk ka ndonjë

¹ Në Pasqyrat financiare statutorë për vitin 2017 në Raportin e auditimit kjo nën-komponentë paraqitet me emërtimin “Lejimet për borxhet e këqija dhe të dyshimta” në vlerë 858,871 €



koment që ka të bëj me Raportin për të Hyrat e Lejuara që ka qenë subjekt i konsultimit publik, gjegjësisht nuk ka komente për kostot apo për komponentët tjerë të të Hyrave të lejuara. Komentet e INDEP-it kryesisht kanë të bëjnë me çështjen e faturimit të konsumatorëve (pa matje – sipas sipërfaqes ngrohëse) dhe strukturës tarifore, ku edhe janë dhënë propozimet përkatëse. Komentet mund të përmbliidhen si në vijim.

Koment 1: Faturimi me çmime sipas temperaturave atmosferike

Me qëllim të reflektimit të sasisë së furnizimit me ngrohje varësisht nga temperaturat atmosferike propozohet që faturimi, respektivisht pagesa për ngrohje të jetë e kategorizuar sipas temperaturave mesatare, siç paraqitet në tabelën vijuese

Pagesa e çmimit	
Temperaturat	Niveli i pagesës
Mbi 10°C	20% ⁷
0 deri 10°C	40%
0 deri -5°C	80%
>-5°C	100%

Koment 2: Tarifa të diferencuara kohore (ditë – natë)

Është propozuar diferencim i tarifave të ngrohjes për periudhat kohore ditë natë, me arsyetimin e optimizimit të konsumit dhe që një ndarje e tillë e tarifave “të reflektojnë konsumin real real të ngrohjes dhe mbron konsumatorët nga faturimi edhe në periudha kur temperaturat janë më të larta dhe shfrytëzimi i ngrohjes është dukshëm më i lartë”.

- Tarifë e ulët (nga ora 6 në mëngjes në ora 18 në mbrëmje)
- Tarifë e lartë (nga ora 18 deri në 6 në mëngjes)

Përgjigje:

ZRRE e mirëkupton shqetësimin lidhur me faturimin sa më të drejtë dhe që pasqyron konsumin real të konsumatorëve, dhe këtë e ka adresuar në kornizën rregullative e më konkretisht në strukturën tarifore, natyrisht aq sa objektivisht është e realizueshme dhe brenda kompetencave dhe përgjegjësiive ligjore.

Për të shpjeguar këtë duhet dhënë një elaborim mjaft të gjerë të kësaj çështje si në aspektin teknik ashtu edhe në aspektin e organizativ për implementim.

Struktura aktuale e tarifave të energjisë termike (ngrohjes qendrore)



Aktualisht ZRRE implementon strukturën tarifore e cila përmban dy lloje të tarifave: i) Tarifat për konsumatorët me matje – bazuar në konsumin e matur; dhe ii) tarifin e konsumatorëve pa matje – bazuar në sipërfaqen ngrohëse të konsumatorëve.

Tarifat me matje adresojnë plotësisht faturimin sipas konsumit, i cili mund të zvogëlohet ose rritet nga vet konsumatori varësisht nga temperaturat atmosferike. Pra besoj se pajtohemi që faturimi me tarifin me matje – bazuar në konsumin e matur është mënyra më e mirë për faturim real të konsumatorëve. Aktualisht këto tarifa zbatohet kryesisht për raste e ashtuquajtura ‘një-nëstacion-një-konsumatorë’ (pra kur një ndërtesë është në pronësi të një konsumatori – si Institucionet, ndërtesat komerciale, shtëpitë individuale etj.) Fatkeqësisht faturimi me tarifin me matje nuk implementohet plotësisht, për shkak të gjendjes aktuale të instalimit të matësve (njehsorëve) dhe për shkak të llojit të instalimeve të brendshme (tipi i ashtuquajtur vertikal i instalimeve) që është prezent në shumicën e ndërtesave të banimit kolektiv – pra në ndërtesat me shumë pronarë të apartamenteve që njëkohësisht janë edhe konsumatorë individual të ngrohjes qendrore. Gjithashtu një faktorë tjetër është edhe mungesa e asociacioneve banesore që në rastet e ndërtesave të banimit kolektiv do të luante rolin e titullarit të ndërtesës respektive.

Tarifin e konsumatorëve pa matje

Për shkak të gjendjes faktike që u përmend shkurtimisht më lartë - pamundësisë së zbatimit të plotë të tarifave me matje, ZRRE ka qenë e detyruar të përcaktoj edhe tarifin pa matje, bazuar në sipërfaqen ngrohëse të konsumatorit, të cilat zbatohen kryesisht në rastet kur është e pamundshme zbatimi i tarifave me matje (p.sh. ndërtesat kolektive) dhe në rastet kur nuk ka matës funksional të energjisë termike.

ZRRE edhe në këtë rast përkujdeset që edhe në këtë rast që këto tarifa të jenë sa më reale dhe të reflektojnë konsumin. Më konkretisht në llogaritjen e konsumit të konsumatorëve pa matje ZRRE merr parasysh disa parametra dhe indikatorë si: konsumin specifik për m^2 kapacitetin termik specifik, dhe ‘Shkallët e Ditëve me Ngrohje’ që merr parasysh ndër tjera edhe temperaturat atmosferike. Në këtë mënyrë përlllogaritet konsumi mesatar për sezonë i konsumatorëve pa matje, i cili konsum merret për alokimin respektiv të të Hyrave të Lejuara, e rrjedhimisht për llogaritjen / përcaktimin e tarifave pa matje. Kjo qasje po ashtu merr parasysh edhe çështje e implementimit. Pra tarifin pa matje bazohen në një konsum të përlllogaritur si mesatare e tërë sezonin, ku kjo mesatare merr parasysh edhe konsumin në muajt më të ngrohtë (p.sh. tetori, prilli) dhe konsumin në muajt më të ftohtë (dhjetori, janari ...). Kjo mesatare për shkaqe të implementimit ndahet në mënyrë të barabartë në të gjithë muajt e sezonit.

Lidhur me këtë duhet përmendur se në kornizën rregullative jemi munduar të tregojmë fleksibilitet kur me rregullore parashihet zgjatja e sezonit përtej datave të përcaktuara, në rastet kur temperaturat atmosferike janë nën $12^{\circ}C$.

Sa i përket propozimit për vendosjen e tarifave të diferencuara kohore (ditë – natë), nuk e kemi të qartë se si mund të reflektoj konsumin real. Duke u ndërlidhur me aplikimin e këtij lloji të tarifave për energjinë elektrike po theksojmë se diferencimi ditë – natë i tarifave të



energjisë elektrike ka për qëllim përshtatjen me kushtet specifike të sistemit elektroenergjetik të Kosovës pra prodhimit / furnizimit në një të anë dhe në anën tjetër të kërkesës për energji elektrike nga konsumatorët.

Sidoqoftë ne mbesim të hapur për të diskutuar dhe argumentuar mbi këto çështje me interes për konsumatorin.

Përgatitur nga DETG, ZRRE